



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:236065
Datë: 11.04.2024
Numri i dokumentit: 05563134

K.DH.SH.II.nr.102/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Radio Televizioni i Kosovës, me seli ne rrugën "Xhemajl Prishtina" nr.12 ne Prishtinë, kundër debitorit "One Air Media" shpk, me seli ne rrugën "Garibaldi" nr.3, kati 2 ne Prishtinë, i cili përfaqësohet nga avokat Taulant Hajdari, ne kuadër te shoqërisë se Avokateve "Sejdiu&Partners", me seli ne lagjen Veternik Kompleksi banesor EXDC, blloku 10 kati 6 nr.18 ne Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2449/2022 dt.10.10.2023, me datë 11.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Radio Televizioni i Kosovës, me seli ne rrugën "Xhemajl Prishtina" nr.12 ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr. 2449/2022 dt.10.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 2449/2022 dt.10.10.2023, e ka pranuar ne tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit "One Air Media" shpk, me seli ne rrugën "Garibaldi" nr.3, kati 2 ne Prishtinë dhe e ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.05/2020 dt.31.01.2020, të lejuar nga Përmbaruesja Private Myjsere Mujku me seli ne Prishtinë si dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimin në këtë çështje përmbarimore, duke vendosur qe secila palë ti bartë shpenzimet e veta.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak te konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te ligjit për procedurën përmbarimore, me propozim qe gjykata e shkallës se dytë ta anuloj aktvendimin e atakuar dhe urdhri përmbarimor te mbetet ne fuqi.

Përgjigje në ankesën e kreditorit ka ushtruar debitori, duke kontestuar te gjitha perëndimet e kreditorit, me propozim qe gjykata e shkalles se dyte ta refuzoj ankesën e kreditorit, aktvendimin e atakuar ta vërtetoj dhe ta detyroj kreditorin qe debitorit t'ia kompensoj shpenzimet procedurale. Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Radio Televizioni i Kosovës, me seli ne rrugën "Xhemajl Prishtina" nr.12 ne Prishtinë, me datën 31.01.2020 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit "One Air Media" shpk, me seli ne rrugën "Garibaldi" nr.3, kati 2 ne Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave nr.011-10 dt.01.11.2019, 010-05 dt.01.10.2019, 003-09 dt.01.09.2019. Përmbartuesja Private Myjsere Mujku, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.05/2020 dt.31.01.2020, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturave si me lartë, ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit nga faturat ne shumen prej 36,757.42 euro, me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga dita e paraqitjes se propozimit për përmbartim e deri ne pagesën definitive te borxhit si edhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhri përmbartimor, debitori me datën 12.02.2020 ka ushtruar prapësim, përmes se cilit shprehet se shuma e pretenduar nga kreditori është llogaritur gabimisht, shuma për muajin Shtator 2019 është paguar plotësisht nga debitori, shuma e pretenduar për muajin Tetor 2019 nuk është paguar dhe shuma e pretenduar për muajin Nëntor 2019 nuk është faturuar mirë pasi periudha e kontratës përfshin vetëm datën 1-6 Nëntor 2019. Debitori asnjëherë nuk ka pranuar ndonjë shkresë apo njoftim nga kreditori lidhur me borxhin ne fjalë, propozon qe gjykata ta aprovoj ne tërësi prapësimin e debitorit, ta anuloj urdhrin përmbartimor dhe ta detyroj kreditorin te paguaj shpenzimet e procedurës.

Përgjigje ne prapësimin debitorit ka ushtruar kreditorit me date 18.02.2020, me arsyetimin se nga arsyet e paraqitura ne prapësim nuk rezulton asnjëra nga bazat ligjore nga neni 71 i LPP qe te anulohet urdhri përmbartimor, debitori nuk ka bashkangjitur asnjë provë me te cilat do te provonte pretendimet e tij. Propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbartimor ta lë ne fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2449/2022 dt.10.10.2023, me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin përmbartimor ashtu që e ka përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret faturat mbi bazën e te cilave është lejuar përmbartimi nuk e kanë kohen e përmbushjes se detyrimit monetar. Sa i përket pagesave gjykata nga lista e transaksioneve bankare te debitorit ka vërtetuar se i njëjti e ka paguar faturën 003-09

dt.01.09.2019 ne shumen prej 8,273.13 euro meqë me datën 03.10.2019 kishte paguar shumen prej 55.5 euro ne favor te kreditorit me përshkrimin pagesë sipas kontratës për Gusht 2019 Radiotelevizioni i Kosovës ndërsa me datën 31.10.2019 kishte paguar shumen prej 14,242.26 euro ne favor te kreditorit me përshkrimin *pagesë sipas kontratës për Shtator 2019*. Për gjykatën meqë transaksioni ne shumën prej 14,242.26 euro e mbulon shumen e faturuar për muajin Shtator për shumen prej 8,273 euro dhe debitori ka caktuar se për cilën faturë është duke bërë pagesën, atëherë gjykata ne bazë te nenit 293 par.1 te LMD vërteton sa fatura 003-09 dt.01.09.2019 është paguar. Sa i përket pranimi te faturave gjykata gjen se debitori e ka pranuar faturën nr.003-09 dt.01.09.2019 për muajin Shtator 2019 dhe meqë e ka paguar atë fature konsiderohet se e ka pranuar ndërsa faturat tjera nr.011-10 dt.01.11.2019, 010-05 dt.01.10.2019 nuk i ka pranuar, gjë qe del edhe nga email-et dt.15.10.2019 dhe 09.10.2019 ku kreditori i kishte dërguar debitorit faturat për muajin Korrik, Gusht dhe Shtator por qe nga shkresat e lëndës nuk ka prova se debitorit i ka pranuar ne ndonjë mënyrë këto fatura. Sa i përket Kontratës për Materializimin e kanaleve te RTK ne Youtube, gjykata gjen se kjo kontrate kishte skaduar me datën 06.11.2019 dhe nuk është vazhduar meqë debitori asnjëherë nuk e ka dhënë pëlqimin e tij për vazhdimin e kontratës. Kjo vërtetohet nga email-et e dt. 25.09.2019 ku kreditorit e njofton debitorin se kontrata mes tyre do te përfundoj me datën 06.11.2019 ndërsa me datën 22.11.2019 e kishte njoftuar përsëri debitorin se kontrata mes tyre ka përfunduar dhe i ka kërkuar ti liroj kanalet ashtu qe debitori me datën 05.12.2019 i ishte përgjigjur kreditorit se kanalet do te lirohen me datën 10.12.2019 ndërsa sa i përket vazhdimi te kontratës gjykata konstaton se kreditori kishte marrë vendim nr.4011/19 për vazhdimin e kontratës me debitorin deri ne përfundim te procedurës se ri shpalljes ndërsa ky i fundit –debitori nuk ka prova se ka dhënë pëlqimin për vazhdimin e kontratës. Gjykata arsyeton se sa i përket situatës me faturën 003-09 dt.01.09.2019 ne shumen prej 8,273.13 euro bazohet ne nenin 71 par.1 nenpar.8 te LPP si dhe nenin 276 te LMD, ndërsa sa i përket situatës për faturat 010-05 dt.01.10.2019 dhe nr.011-10 dt.01.11.2019 rregullohet me nenin 29 ar.1 dhe 3 te LPP sepse këto fatura nuk janë pranuar pasi nuk përmbajnë as nënshkrimin dhe as vulën e debitorit si dhe nuk ka prova ne lëndë se janë pranuar përmes emailit nga debitori. Po ashtu këto fatura nuk plotësojnë kushtet nga neni 29 par.3 i LPP pasi nuk e kanë as afatin kohor te përmbushjes se detyrimit dhe nuk ka deklaratë se fatura është bere e arritshme. Andaj bazuar nga te lartcekurat dhe fakti se fatura për muajin Shtator 2019 konsiderohet se është pranuar nga debitori ndërsa faturat për muajin Tetor dhe Nëntor 2019 nuk janë pranuar nga debitori , gjykata ne tërësi e aprovoi prapësimin e debitorit dhe anuloi urdhrin përmbarimor si dhe përfundoj procedurën ne këtë çështje përmbarimore konform nenit 71, 7, te LPP lidhur me nenin 13 te Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm përfundimin juridik te gjykatës se shkalles se parë, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes.

Mbi bazën e faktit se procedura përmbartimore në këtë çështje është mbështetur në faturat nr.011-10 dt.01.11.2019, 010-05 dt.01.10.2019, 003-09 dt.01.09.2019 të lëshuara nga kreditori, edhe kjo gjykatë në analizë të këtyre faturave vlerëson përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se fatura nr.003-09 dt.01.09.2019 konsiderohet e paguar e kjo sepse bazuar në transaksionin bankar që është në lënde shuma prej 14,242.26 euro ka të bëjë me pagesën sipas kontratës për muajin Shtator 2019 dhe pasi që kjo pagesë e tejkalon shumën nga fatura me vlerën prej 8,273.13 euro, konsiderohet se kjo faturë është paguar e me këtë edhe se është pranuar nga ana e debitorit sepse nuk është kontestuese nga asnjëra palë në procedurë të cilat e kanë pohuar këtë pagesë, ndërsa pagesa nga debitorin nuk është kontestuese nga palët.

Sa i përket faturave nr.011-10 dt.01.11.2019, 010-05 dt.01.10.2019 edhe kjo gjykatë vlerëson se këto fatura nuk i plotësojnë kushtet ligjore nga neni 29 par.3 të LPP sepse nuk përmbajnë në mënyrë kumulative elementet që duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm ligjor për të qenë dokument i besueshëm sepse të njëjtat nuk janë të nënshkruara e as të vulosura nga ana e debitorit, duke ditur faktin se nënshkrimi i pranuesit është kusht esencial mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbartueshmërisë së titullit ekzekutiv dhe mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimi si i tillë nga debitorin, shtu këtu faktin se këto fatura nuk e kanë as afatin kohor të përmbushjes së detyrimit ndërsa në shkresë të lëndës nuk ka prova se kreditori ka deklaruar se faturat janë bere të arritshme, si edhe nuk ka prova se këto fatura janë pranuar në mënyrë tjetër nga ana e debitorit.

Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtyre kushteve dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbartues sepse rezulton se debitorin nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbartimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbartimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve. Sa i përket çështjes së Kontratës për materializimin e kanaleve të RTK në youtube të lidhur me kreditoret dhe debitorin edhe kjo gjykatë vlerëson përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sepse në lënde nuk ka prova se debitorin ka pranuar vazhdimin e kontratës apo se ka dhënë pëlqimin për vazhdimin e saj.

Andaj, duke marrë parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe as zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Numri i lëndës: 2023:236065
Datë: 11.04.2024
Numri i dokumentit: 05563134

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.102/24 dt. 11.04.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi